



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 11/15

Prishtinë, më 17.3.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Bali Muharremaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Visar Ymeri, Bojan Mitić dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti- Ministri i Financave, Agim Krasniqi - Zv. Ministër në MF, Idriz Blakaj - Drejtori i AMKMK.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Qendrim Imeri- Gazetar nga INFODIREKT, Lumnije Murati nga Zyra e Presidentes së Kosovës, Deli Sadiku- Kamerman nga KosvovaPress.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 4.3.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për reformën shëndetësore;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtitshme;
5. Shqyrtimi i Kërkesë së Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për bashkëfinancimin e projektit të Komunës së Gjakovës;
6. Shqyrtimi i Rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatoj se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 4.3.2015

Kryetari - konstatoj se komisioni miratoi procesverbalin pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për reformën shëndetësore

Kryetari - marrëveshja për financim e nënshkruar nga Republika e Kosovës me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim që është Agjencion i Bankës Botërore, ka për qëllim financimin e aktivitete që kanë të bëjnë me reformën në shëndetësi. Asociacioni pajtohet t'i jap Kosovës një kredi në shumën e barasvlershme me 20.45 milion euro apo 16,500,000 SDR. Marrëveshja do të filloj të implementohet gjatë vitit 2015 dhe pritët të përfundoj në vitin 2019. Sa i përket kushteve të kredisë, pagesat e normës së interesit prej 1.25% vjetore, tarifën e shërbimit prej 0.75% vjetore, tarifën e zotimi prej 0.5% vjetore. Gjithsej shpenzimet për interes, parashihet të jenë rreth 5.01 milion euro Afati i kthimit të kredisë do të jetë me grejs periudhë në kohëzgjatje prej 5 vite dhe afat amortizimi për 20 vite, nga viti 2019-2039.

Avdullah Hoti – marrëveshja që kemi arritur me bankën botërore është në përputhje me prioritetet e qeverisë për financimin e reformës së shëndetësisë, më konkretisht në katër fusha. Kushtet e kredisë janë shumë të favorshme me normat të ulta të interesit, kemi një grejs periudhë për pesë vitesh me një afat kthimi prej 20 vitesh.

Kryetari - theksoi se e ka një gabim teknik që duhet të përmirësojmë në marrëveshje, në tekstin në gjuhën shqipe, që është shënuar shuma 1,200,000 SDR, ndërsa në gjuhën angleze dhe serbe 16,500,000 SDR. Pra teksti në gjuhën shqipe duhet harmonizuar me tekstin në gjuhën angleze dhe serbe.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për reformën shëndetësore.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme

Kryetari – edhe kjo marrëveshje është nënshkruar me Bankën Botërore dhe kushtet janë të njëjta si tek marrëveshja e parë, por vetëm shuma ndryshon 24,980 milion euro. Qëllimi i projektit ka të bëjë me investimet në eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme në objektet publike. Marrëveshja ka për qëllim zbatimin e projektit për themelimin e Njesisë në Agjesionin e Kosovës për eficiencë të energjisë, punësimin e personelit, menaxhimin e financave dhe monitorimin e vlerësimit të projektit dhe ofrimin e trajnimeve për të punësuarit. Pra qëllimi i saj është përkrahja e energjisë alternative.

Avdullah Hoti – sqaroi se janë në dy qëllime që përdore kjo kredi. E para mjete të investohen në objekte komunale, si në shkolla, në shtëpi të shëndetit, në izolimet dhe ruajtjen e objektit të energjisë, por edhe në ruajtjen e energjisë për panele solare që e shfrytëzojnë energjinë. Ndërsa qëllimi tjetër është i asistencës teknike që është zhvillimi i bazës ligjore dhe nxjerrja e akteve nënligjore, trajnimet e stafit dhe përkrahja e punës së agjencionit për emergjencë të energjisë të ripërtëritshme. Shuma që do të merret kredi është 24.3 milion euro, ndërkaq në emër të interesit, do të kthehet shuma 6.87 milion euro.

Besa Gaxherri – ndoshta për neve në këto momente që kemi nevojë për gjithçka, na duket një luks investimi në objektet që na ndihmojnë në eficiencën e energji, po realisht kjo është e domosdoshme, aq më shumë kur ne kemi mundësi me e marr një kredi me këto kushte të favorshme. Mendojë që është mirë që do vendosen kriteret për eficiencën e energjisë për objektet publike, por edhe në objektet tjera që po ndërtohen, duhet të vendosen mekanizma që të mos të mund të marrin leje, pa i plotësuar këto kushte që kanë të bëjnë me eficiencën e energjisë, sepse qytetarëve shpenzojnë më shumë energji, ku objekti nuk finalizohet ashtu siç kërkohet me kriteret. Për mua është e pranueshme marrëveshja dhe ju përgëzojë edhe për mënyrën teknike të përgatitjes së marrëveshjes dhe materialeve tjera që ofrojnë informata dhe argumente të mjaftueshme për të kapuar atë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme.

5. Shqyrtimi i Kërkesë së Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për bashkëfinancimin e projektit të Komunës së Gjakovës

Kryetari – sqaron se kërkesa e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale ka të bëjë me transferin e mjeteve prej 20,000 eurove në Komunën e Gjakovës, si rezultat i një marrëveshje që kanë pasur këto dy institucione vitin e kaluar, për të financuar projektin kapitale “Lapidari i Lirisë”. Për këtë projekt Komuna e Gjakovës ka ndarë 30,000 euro dhe në bazë të informatave që kam marrë prej drejtorit të financave në Komunën e Gjakovës, Komuna i ka shpenzuar këto mjete për këtë projekt vitin e kaluar dhe ka mbetur që pjesa tjetër e mjeteve të transferohet nga Agjencia për të përfunduar projekti. Kjo duhet të bëhet përmes Kuvendit, pasi që Ligji i buxhetit thotë se transferi në mes organizatave buxhetore bëhet me aprovim të Kuvendit.

Idriz Blakaj – sqaroi se marrëveshja është nënshkruar vitin e kaluar dhe ne nuk kemi mundur ti bartim mjetet pasi që Kuvendi nuk ka qenë i konstatuar. Meqë jemi marr vesh, kam dëshirë të qëndroj pas marrëveshjes sime dhe prandaj kam bërë kërkesën për transferin e 20,000 euro në Komunën e Gjakovës.

Kryetari – për me u bërë transferi duhet që kërkesa të jetë teknikisht e specifikuar se ku mirren edhe ku transferohen mjetet, për të mundur të bëjmë rekomandimin si komision.

Agim Krasniqi - sqaroi se pasi që kanë marrë të gjitha materialet dhe informatat, kanë kuptuar se projekti në fjalë në Komunën e Gjakovës ka nisur vitin e kaluar dhe komuna ka ndarë mjetet, ndërkaq projekti nuk ka përfunduar, pasi që Agjencia nuk ka transferuar pjesën e vet të mjeteve. Mendojë që kjo është dashtë të kryhet nga Agjencia në kohën kur është përgatit dhe miratue buxheti i Kosovës për vitin 2015, në mënyrë që të barten mjetet dhe kjo nuk ka ndodhur. Prandaj, tani në rrethanat që jemi, mbështetur në nenin 30 të LMFPD dhe nenit 13.6 të Ligjit të Buxhetit 2015, transferi mund të bëhet

vetëm pas miratimit nga Kuvendi, sepse kështu parashihet kur kemi transfer në mes organizatave buxhetore. Gjithashtu, Agjencia në kërkesën e saj duhet të specifikojë teknikisht emrin e projektit, ku merren dhe qiten mjetet. Po ashtu si Ministri e Financave, kemi thënë se agjensioni edhe organizatat tjera, nuk duhet të marrin obligime pa i përfunduar obligimet i tyre që kanë.

Safete Hadergjona - në tabelën e buxheti ku janë projektet kapitale 4.2., projekti në Komunën e Gjakovës nuk figuron fare, kjo lenë të kuptohet se kemi të bëjmë me një projekt të ri që po fillon. Si mundemi ne me ditë se Komuna e Gjakovës e ka ndarë shumën prej 30,000 euro në buxhetin këtij viti?

Agim Krasniqi - sqaroi se Komuna e Gjakovës, vitin e kaluar e ka pas projektin në të cilin i ka shpenzuar mjetet e veta të ndara për këtë qëllim, dhe tani teknikisht ne duhet ta kthejmë në buxhet projektin e caktuar siç ka qenë vitin e kaluar me të njëjtin emër dhe kod.

Safete Hadergjona – në materialin që e kemi marrë, nga shkresat e Komunës së Gjakovës, shohim se nuk kemi vendim të nënshkruar nga Kuvendi Komunal, por një Përfundim nga Bordi i Drejtorëve të nënshkruar nga Kryetarja e Komunës dhe është pak problematike çështja e procedurave. Ne nuk jemi kundër Lapidarit të Lirisë, por këto janë çështje që është dashtë të futen në buxhet me kohë dhe të vazhdohet me projekt, e mos të vijmë në problematiken e mosrespektimit të procedurave ligjore.

Agim Krasniqi - komuna mbi bazën e marrëveshjes ka nënshkruar kontratën për me e krye këtë projekt dhe i ka ndarë mjetet e veta dhe pjesa tjetër e mjeteve ka mbet të paguhet prej agjencisë, ashtu siç është marrë obligimi dhe tani e vetmja mundësi është që bëhet transferi i mjeteve dhe këtë mund ta bëjë vetëm Kuvendi në bazë të ligjeve në fuqi.

Kryetari – ne kemi një marrëveshje në mes Komunës edhe Agjencisë, ministria e financave sqaron saktë mënyrën e transferim të mjeteve, ku kërkohet një votim i Kuvendit për me legjitimue një transfer të tillë siç e parasheh ligji, dhe kjo nuk është teknikisht e parealizueshme për arsye se ka obligime kontraktuale. Përveç se kërkohet që të precizohet teknikisht kërkesa për transferin e mjeteve dhe Agjencia duhet të komunikojë me Komunën e Gjakovës dhe Ministrin e Financave, që ta specifikojnë kërkesën teknikisht.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Të miratohet kërkesa për transferin e mjeteve buxhetore prej 20,000 (njëzetë mijë) euro, nga buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, nga projekti kapital “Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, Prekaz-Skenderaj” me kod 13851, në buxhetin e Komunës e Gjakovës për vitin 2015, në projektin kapital “Projektet e ndryshme kapitale me bashkëfinancim”, me kod 41023, programi “Buxhet dhe Financa” (632175), nën-programi “Buxhetimi” (175160).

6. Shqyrtimi i Rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione

Kryetari – lexoi rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Më tutje kryetari shtoi se rekomandimi nr. 2 i cili thotë: se Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim-ndryshim të Ligjit të Republikës së Kosovës për 2015, të përcaktoj masat e përshtatshme të cila e shkarkojnë çmimin e energjisë elektrike për konsumatorët shtëpiak, duke përfshirë edhe rritjen e shumës buxhetore për mbulimin e pagesave të energjisë elektrike për familjet në nevojë, ka të bëjë me komisionin tonë, pasi që

lidhet me koston buxhetore dhe është kërkuar prej nesh të bëjë një raport me rekomandime. Unë kam kërkuar nga Ministria e Financave të bëjë një vlerësim të këtyre rekomandimeve dhe e kemi marrë me shkrim.

Agim Krasniqi – sqaroi se çështja e përcaktimit të çmimit të energjisë elektrike është në kompetencën e ZRRE-së, dhe ne nuk kemi bërë ndonjë vlerësim në këtë pikë. Por ne kemi dhënë dy sqarime që janë shtruar për buxhetin. Me Ligjin për buxhet 2015, janë të ndara 4.5 milion euro për përfituesit e familjeve në raste sociale dhe duhet me treguar që ministria e financave nuk mund të jep zotim që ka me ndarë mjete shtesë me rishikimin e buxhetit. Ministria e Financave është në proces të hartimit të Ligji për TVSH-në, dhe si pjesë e draft-propozimit është edhe zbritja e normës së TVSH-së për konsumin e energjisë elektrike, që realisht duhet me ndikue që me pas një zbritje të energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët. Gjithashtu në vlerësimin tonë, kemi thënë se nuk do të duhej zvogëlohej tantiema për shfrytëzim të qymyrit sepse planifikimet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2015 dhe vitet në vijim nuk ofrojnë një fleksibilitet të tillë në të hyrat buxhetore. Këto janë tri çështje që hasin në ministrin e financave, e pjesa tjetër është përgjegjësi edhe kompetencë e zyrës së rregullatorit të energjisë.

Kryetari – ne na janë prezantuar tri pika, ndërkaq objekt shqyrtimi për ne është pika 2 që ka të bëjë me koston buxhetore. Ne mundemi me përmend që në Buxhetin e Kosovës, janë ndarë 4.5 milion euro në emër të pagesës së energjisë elektrike për familjet në nevojë nuk ka mundësi të tjera të rritjes së shumës e cila figuron në buxhet.

Avdullah Hoti – sqaroi se në draft-ligjin e ri të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, që po punojmë dhe shumë shpejt do ta sjellim në Kuvend, është paraparë zvogëlimi i TVSH-së në konsumin e energjisë elektrike nga 16% në 8%. Janë diku rreth 17 milion euro që mbledhim prej TVSH-së në konsumin e energjisë prej KEK-ut dhe KEDS-it, dhe nga kjo kuptojmë se ne do ti subvencionojmë familjet apo konsumatorët edhe për 8 milion euro.

Kryetari – pyeti a është fjala vetëm për shtëpiakët që subvencionohen apo edhe harxhuesit tjerë të energjisë?

Avdullah Hoti - sqaron se lirim e TVSH-së në konsumin e energjisë elektrike, përfitojnë të gjithë konsumatorët.

Bardhyl Meta – ne mundimi me zbulue insetiven apo nxitjen për investitorët e huaj sa të duam, por kur ata vijnë me prodhues diçka dhe e shofin energjinë dyfish më të lartë, pastaj edhe problemet tjera që iu dalin për deponimin e mjete për të krijuar lidhje të veçantë, të gjitha këto tregojnë se ata, që në fillim hasin në probleme të mëdha. Prandaj, është mirë të rishikohet dhe të ngutet ky proces, përndryshe edhe viti 2015, ka me na shkue pa investime të jashtme.

Besa Gaxherri – mendojë që është dashur që rekomandimet ti shkojnë për shqyrtim edhe komisionit për zhvillim ekonomik, sidomos për pikën 1 dhe 3 pasi që ai komision është kompetent për këto çështje, dhe mandej me na ardhur një rekomandim prej këtij komisioni dhe tek pastaj ne të deklarohejmë për koston buxhetore. Kuvendi duhet të merret me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe kjo Agjenci duhet të jetë shumë më e kujdesshme, sepse në disa raste ka bërë rritje të tarifave ndoshta të paarsyeshme dhe prandaj, po kemi edhe këso raste të problemeve sociale por edhe probleme politike. Unë kisha propozuar të mos marrim vendim sot, dhe të kërkojmë që me u marr edhe komision për zhvillim ekonomik, si dhe të diskutojmë a mundemi me e thirr dhe ZRRE-në me i harmonizue punët sa i përket kësaj çështje. Ndërkaq është e mirëseardhur puna e Ministrisë së Financave në ndryshimin e politikave fiskale, përshtirë edhe propozimet për uljen e TVSH-së në konsumin e energjisë elektrike.

Safete Hadergjonaj – për çështjen që flasim është një rast shumë i ndjeshëm sepse ka të bëjë me familjet në nevojë. Unë propozoj që në këtë mbledhje të mos e vendosim për këtë çështje, por të formulohet rekomandimi dhe në një mbledhje tjetër të komisionit e formulojmë bashkërisht rekomandimin përfundimtar dhe pastaj të procedohet më tutje.

Kryetari - ne mundemi me thënë në rekomandim se ministria e financave ka ndarë shumën prej 4,5 milion euro, për buxhetin e vitit 2015. Po ashtu të themi që Qeveria sa më parë të procedojë Projektligjin mbi vlerën e shtuar, ku është paraparë edhe zbritja e TVSH-së për konsumin e energjisë elektrike nga 16% në 8%. Sa i përket politikave të rrymës, komisioni funksional, qeveria apo ministria përkatëse, po ashtu edhe ndërmarrja publike, të japin vlerësime tjera për çështjet tjera që kanë të bëjnë me rritjen e energjisë elektrike.

Latif Gashi - unë kisha propozuar të caktohet një grup punuese dhe të merremi me të?

Bardhyl Meta – nga rekomandimi shihet se pika e 1 dhe 3 kanë të bëjnë me Rregullatorin e Energjisë dhe për këtë kompetentë është komisionin për zhvillim ekonomik, ndërkaq pika e 2 ka të bëjë me Komisionin për Buxhet dhe Financa. Megjithatë, mendoj se lënda duhet të trajtohet në tërësi, dhe është më e rëndësishme që kjo çështje të trajtohet edhe prej komisionit për zhvillim ekonomik, të shohim vlerësimet edhe rekomandimet e tyre, dhe pastaj ne të merremi me koston buxhetore.

Kryetari - në duhet të nxjerrim rekomandim për Kryesin e Kuvendit për pikën e dytë, pika e parë dhe të tretë nuk është kompetencë e këtij komisioni.

Safete Hadergjonaj – unë propozoj që të formulohet rekomandimi, dhe të diskutohet edhe një herë një mbledhjen e komisionit, para se të procedohet më tutje.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Raporti me rekomandime i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, të përpilohet, mbështetur në diskutimet e anëtarëve të Komisionit, dhe i njëjti të diskutohet dhe votohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari - amendamenti 8 i propozuar nga GP Vendvendosjes me përkrahjen e komisionit funksional , nuk ka kuptim për mua. Mënyra se si është hartuar, lenë të kuptohet se shitja e aksioneve të ndërmarrjeve të këtij ligji mund të tjetërsohen vetëm pasi që vendimi i miratuar i qeverisë të jetë votuar nga Kuvendi i Kosovës me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Përcaktimi i numrit të tillë të votave, tregon se Kuvendi kurrë nuk mund të marr vendime të tilla. Kjo nuk është praktike dhe me këtë formë ne po pengojmë tërheqjen e investimeve të jashtme, punësimin dhe zhvillimin.

Bardhyl Meta - unë pajtohem me kryetarin me vërejtjet e këtij ligji, madje këtu kemi një absurd, ku për miratimi i ligjit kërkohet me shumicë të thjeshtë, ndërsa për çështjen e shitjes së aksioneve kërkohen 2/3 e votave. Nuk ka praktikë në botë ku kompanisë me një qarkullim 1 miliard euro, që ka statusin e shitjes së aksioneve, ku kërkohet votimi i 2/3 të votave dhe aty kërkohet shumica, dhe nuk mundemi që për çdo

ndërmarrje publike apo shoqërore, të thërrasim Parlamentin për shitjen e 2 apo 3 % të aksioneve. Ajo thjeshtë një politikë për të penguar investitorët e huaj dhe mos me lejue të shiten asnjë prej aksioneve të aseteve. Ne nuk kemi nevojë që patjetër pozita të arrijë konsensus me opozitën dhe e kundërta, kur kemi dy qasje të kundërta për ekonomi edhe për politikat ekonomike.

Kryetari - një amendament tjetër flet për përbërjen e bordeve të drejtorëve në ndërmarrjet publike të jetë në harmoni me ligjin për barazinë gjinore, kjo nuk ka kuptim. Çka ka lidhje kjo me barazi gjinore, kur përbërja e bordit është e natyrës profesionale!

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Të ndryshme

Kryetari – njoftoi se në takimin e radhës së komisionit, do të propozojë themelimin e grupit punues për fillimin e punës në hartimin e Projektligjit për Institucionet Mikrofinanciare.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani